

STATISTIKA TË KULTURËS

2022



STATISTIKA TË KULTURËS 2022

Drejtor botimi: **Dr. Elsa Dhuli**

© Copyright INSTAT 2023

Ndalohej riprodhimi i këtij botimi apo transmetimi i tij në cilëndo formë, pa autorizimin paraprak me shkrim të mbajtësit të së drejtës së autorit.

INSTITUTI I STATISTIKAVE
Rr. Vllazën Huta,
Ndërtesa 35, Hyrja 1
Tiranë, Kodi Postar 1017
Tel: + 2233356 / 2222411 4 355
Fax: 411 2222 4 355+
e-mail: info@instat.gov.al
www.instat.gov.al

Dizajn: Gentian Suçi

STATISTIKA TË KULTURËS

2022



INSTAT publikon statistika në kulturë, duke u përqëndruar në pjesëmarrjen kulturore dhe në dimensionin ekonomik të kulturës. Treguesit e paraqitur lidhen me pjesëmarrjen dhe trashëgiminë kulturore, edukimin dhe punësimin në kulturë. Gjithashtu, seksione të veçanta i dedikohen edhe përdorimit të internetit për qëllime kulturore si dhe shpenzimeve publike në kulturë.

PJESËMARRJA NË KULTURË

Muzika, përmbajtjet audio-vizuale, performancat live dhe forma të tjera kulturore promovojnë vlerat e shoqërisë shqiptare dhe shërbejnë si forma që lidhin njerëzit dhe shoqërinë. Pjesëmarrja në aktivitetet kulturore duket të ketë një ndikim të konsiderueshëm në cilësinë e jetës së çdo individi dhe në mirëqënien e shoqërisë në përgjithësi.


Ky seksion paraqet të dhëna për pjesëmarrjen kulturore, bazuar në anketën e të Ardhurave dhe Nivelit të Jetesës që INSTAT zhvillon dhe në të dhënat administrative, të siguruar nga Ministria e Kulturës lidhur me numrin e aktiviteteve kulturore dhe numrin e pjesëmarrësve në aktivitetet kulturore.

Anketa e të Ardhurave dhe Nivelit të Jetesës mbledh të dhëna për pjesëmarrjen në aktivitete kulturore me pagesë të individëve mbi 16 vjeç. Aktivitetet kulturore përfshijnë vizitat në teatër, kinema, koncerte, aktivitete sportive etj.

Në vitin 2021, 27,2% e individëve mbi 16 vjeç raportuan se morën pjesë rregullisht në të paktën një aktivitet kulturor gjatë 12 muajve të fundit.

Për të dyja vitet, vihet re që burrat kanë përqindje më të lartë të pjesëmarrjes në aktivitetet kulturore krahasuar me gratë. Në vitin 2021, morën pjesë rregullisht në aktivitete kulturore 29,1% e burrave përkundjet 25,1% e grave.

Fig. 1 Pjesëmarrja në aktivitete kulturore për individët mbi 16 vjeç



Burimi: Anketa e të Ardhurave dhe Nivelit të Jetesës



Të dhënat administrative nga Ministria e Kulturës i referohen numrin të shfaqjeve, premierave të organizuara gjatë vitit nga institucionet qendrore të artit, në varësi të Ministrisë së Kulturës.

Gjatë vitit 2022, janë organizuar gjithsej 798 shfaqje dhe premiera në institucionet qendrore të artit. Krahësuar me vitin e kaluar, numri i shfaqjeve dhe premierave ka pësuar rritje të konsiderueshme. Në institucionet qendrore të artit, gjatë vitit 2022, morën pjesë në aktivitetet kulturore 104.366 spektatorë, përafërsisht trefish më shumë, krahasuar me vitin 2021.

Tab. 1 Numri i shfaqjeve/premierave dhe spektatorëve në institucionet qendrore të artit

Shfaqje/premiera		INSTITUCIONE TË ARTIT	Spektatorë	
Viti 2021	Viti 2022		Viti 2021	Viti 2022
57	70	Teatri Kombëtar Popullor	6.446	12.391
159	319	Teatri Kombëtar Eksperimental	11.981	26.763
99	175	Teatri Kombëtar i Operas, Baletit dhe Ansamblit Popullor	7.151	15.639
146	188	Qendra Kombëtare e Kulturës për Fëmijë	10.149	27.023
51	46	Cirku Kombëtar	2.364	22.550
512	798	Gjithsej	38.091	104.366

Burimi: Ministria e Kulturës


TRASHËGIMIA KULTURORE

Koncepti i trashëgimisë kulturore shoqërohet me tërësinë e pasurive kulturore, të cilat shprehin vlerat, identitetin, njohuritë, traditat, besimet si dhe pasuritë kulturore të një shoqërie. Trashëgimia kulturore identifikohet me monumente, muze, vende arkeologjike, parqe dhe kala etj. Përveç pasurive materiale, pjesë e trashëgimisë kulturore janë dhe pasuritë jomateriale, aspekte të paprekshme si muzika, vallëzimi, ritualet ose tradita të cilat trashëgohen dhe përcillen brez pas brezi.

Në listën e pasurive kulturore botërore të mbrojtura nga UNESCO, Shqipëria është e përfaqësuar si nga trashëgimia materiale dhe ajo jomateriale (Tab. 2).



Tab. 2 Trashëgimia kulturore kombëtare e përfaqësuar në UNESCO



Burimi: UNESCO




Tabela 3 paraqet listën e institucioneve të trashëgimisë kulturore materiale, të cilat janë në varësi të Ministrisë së Kulturës si dhe frekuentimin nga vizitorë vendas dhe të huaj për secilin institucion. Gjatë vitit 2022, numri i vizitorëve në institucionet e trashëgimisë materiale është 689.283 vizitorë, 46,5 % e të cilëve janë të huaj. Parqet arkeologjike janë pasuritë të cilat janë frekuentuar më së shumti nga vizitorët e huaj, ndërkohë vizitorët vendas kanë preferuar më shumë Muzetë.

Tab. 3 Vizitorë në muze, kala dhe monumente të tjera, parqe arkeologjike

Trashëgimia kulturore	Nr.institucioneve	Viti 2021			Viti 2022		
		Të huaj	Vendas	Gjithsej	Të huaj	Vendas	Gjithsej
Muze	12	59.136	73.087	132.223	130.063	137.536	267.599
Kala e Monumente të tjera	7	60.951	88.844	149.795	52.053	125.288	177.341
Parqe Arkeologjike	9	48.408	93.139	141.547	138.672	105.671	244.343
Vizitorë gjithsej	28	168.495	255.070	423.565	320.788	368.495	689.283

Burimi: Ministria e Kulturës

Fig. 2 Përqindja e vizitorëve të huaj në muze, kala dhe monumente të tjera, parqe arkeologjike



Burimi: Ministria e Kulturës


Tabela e mëposhtme paraqet muzetë, kalatë dhe parqet më të frekuentuara nga totali i vizitorëve vendas dhe të huaj, për secilën kategori, për vitin 2022. Ndër muzetë, të cilët janë në varësi të Ministrisë së Kulturës, Muzeu “Gjergj Kastrioti” është muzeu më i frekuentuar (26,1%), ndjekur nga Muzeu Historik Kombëtar (20,7%). 78,0% e vizitorëve kanë frekuentuar Kalanë e Gjirokastrës. Ndërkohë, ndër parqet më të frekuentuara renditen Parku Arkeologjik Shkodër (38,6%) dhe Parku Kombëtar Butrint (25,0%).

Tab. 4 Frekuentimi në institucionet e trashëgimisë materiale, 2022 (%)

Institucione të trashëgimisë materiale	% e frekuentimit
Muze	
Muzeu Gjergj Kastrioti, Krujë	26,1%
Muzeu Historik Kombëtar, Tiranë	20,7%
Muzeu Ikonografik Onufri, Berat	14,9%
Muzeu i Përgjimeve “ Shtëpia me Gjethe”	11,7%
Muze të tjera	26,6%
Vizitorë gjithsej në muze	267.599
Kala e Monumete të tjera	
Kalaja Gjirokastrë	78,0%
Kala të tjera	22,0%
Vizitorë gjithsej në kala	177.341
Parqe Arkeologjike	
Parku Arkeologjik Shkodër	38,6%
Parku Kombëtar Butrint	35,0%
Parku Arkeologjik Apollonia	21,4%
Parqe të tjera	5,0%
Vizitorë gjithsej në parqe	244.343

Burimi: Ministria e Kulturës

Fig. 3 Pesë institucionet e trashëgimisë materiale më të frekuentuara, 2022



Burimi: Ministria e Kulturës, INSTAT

PËRDORIMI I INTERNETIT PËR QËLLIME KULTURORE

Një pjesë e konsiderueshme e shoqërisë merr pjesë në aktivitete kulturore në saj të teknologjive moderne të internetit. Nëpërmjet anketës së përdorimit të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK) në Familje dhe nga Individët, që INSTAT zhvillon, është matur përdorimi i rregullt i internetit nga personat 16-74 vjeç për informacione ose aktivitete kulturore. Aktivitetet online kulturore përfshijnë pjesëmarrjen në rrjete sociale, leximin e gazetave, revistave në internet, komunikimin me mesazhe të shkurtra dhe blerjet online të librave, revistave, gazetave.

Të dhënat për përdorimin e internetit për qëllime kulturore janë fokusuar në frekuencën me të cilën popullata e njerëzve që kanë përdorur internetin në tre muajt e fundit kanë kryer aktivitete të ndryshme.

Në vitin 2022, në total 79,3% e popullsisë 16-74 vjeç kanë përdorur internetin në “tre muajt e fundit” nga momenti i kryerjes së intervistës për qëllime të ndryshme. Ndërkohë, përqindja e përdorimit të internetit në “tre muajt e fundit” për qëllime kulturore si ‘Leximi i gazetave dhe revista online’ është 69,7% dhe ‘Dëgjimi i muzikës (radio në internet, transmetim i muzikës)’ është 67,0%. Përqindje këto dukshëm më të larta se përqindjet përkatëse të regjistruara për ‘Shikimi i kanaleve televizive ose videoe të transmetuara në internet’ (49,5%) ose ‘Luajtja ose shkarkimi i lojërave përmes internetit’ (38,0%).

Analizuar sipas nivelit arsimor, nga tabela vihet re se përdoruesit e internetit me një nivel më të lartë arsimor në përgjithësi kanë përdorur më shumë internetin për qëllime kulturore sesa individët me një nivel më të ulët arsimor. Për të gjitha kategoritë kulturore, individët 16-74 vjeç me arsim të lartë kanë përqindjen më të lartë të përdorimit të internetit për qëllime kulturore.

Tab. 5 Përdorimi i internetit për qëllime kulturore sipas nivelit arsimor, 2022
(% e individëve mes individëve që përdorën internetin në tre muajt e fundit)

2022		Leximi i lajmeve në gazeta / revista në internet	Shikimi i kanaleve televizive ose videoe të transmetuara në internet	Dëgjimi i muzikës (radio në internet, transmetim i muzikës)	Luajtja ose shkarkimi i lojërave
Gjithsej		69,7	49,5	67,0	38,0
Niveli arsimor	Arsimi i mesëm i ulët ose më pak (0-2)	57,5	39,1	58,0	32,0
	Arsimi i mesëm i lartë dhe pas të mesëm jo-i lartë (3-4)	72,7	52,3	69,1	41,6
	Arsim i lartë (5-8)	86,7	63,5	79,6	42,3

Burimi: Anketa e përdorimit të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK) në Familje dhe nga Individët

Dallimet në aktivitetet kulturore sipas grup-moshave

Të rinjtë të grup-moshës 16 deri në 24 vjeç, e përdorën më shumë internetin, për të gjitha aktivitetet kulturore. Në vitin 2022, rreth 90,9 % e përdoruesve të internetit në këtë grup-moshë e kanë përdorur internetin për aktivitetin ‘Dëgjimi i muzikës (radio në internet, transmetim i muzikës)’, krahasuar me 67,0% të të gjithë popullsisë së synuar 16-74 vjeç dhe 40,3% të përdoruesve të internetit të moshës 55 deri në 74 vjeç.

79,4% e të rinjve e kanë përdorur internetin për aktivitetin 'Shikimi i kanaleve televizive ose videove të transmetuara në internet', krahasuar me 49,5% të gjithë popullsisë dhe 22,1% të përdoruesve të internetit të grup-moshës 55 deri në 74 vjeç.

Grup-mosha 25-54 dhe 55-74 vjeç e përdorën më shumë internetin për aktivitetin 'Leximi i lajmeve në gazeta, revista në internet', respektivisht 74,4% dhe 51,9%, dhe më pak për aktivitetin 'Luajtja ose shkarkimi i lojërave', respektivisht 37,7% dhe 12,7%.

Tab. 6 Përdorimi i internetit për qëllime kulturore sipas grup-moshës dhe gjinisë, 2022
(% e individëve mes individëve që përdorën internetin në tre muaj e fundit)

2022		Leximi i lajmeve në gazeta, revista në internet	Shikimi i kanaleve televizive ose videove të transmetuara në internet	Dëgjimi i muzikës (radio në internet, transmetim i muzikës)	Luajtja ose shkarkimi i lojërave
Gjithsej		69,7	49,5	67,0	38,0
Grup-mosha	16-24	76,8	79,4	90,9	70,1
	25-54	74,4	50,6	69,8	37,7
	55-74	51,9	22,1	40,3	12,7
Gjinia	Meshkuj	73,9	53,2	69,7	43,5
	Femra	65,6	45,7	64,2	32,6

Burimi: Anketa e përdorimit të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK) në Familje dhe nga Individët

Dallimet në aktivitetet kulturore sipas gjinisë

Analizuar sipas gjinisë për çdo aktivitetet kulturor të kryer në internet gjatë 3 muajve të fundit, janë meshkujt të cilët regjistrojnë përqindjet më të larta të përdorimit të internetit për qëllime kulturore, me përjashtim të aktivitetit 'Blerje online e librave, revistave, gazetave', ku femrat rezultojnë si përdorueset më frekvente të internetit.

Tab. 7 Përdorimi i internetit për qëllime kulturore sipas gjinisë, (në %)

Përdorimi i TIK për qëllime kulturore	Viti 2020		Viti 2021		Viti 2022	
	Meshkuj	Femra	Meshkuj	Femra	Meshkuj	Femra
Pjesëmarrja në rrjetet sociale (krijim profili duke postuar mesazhe ose aktivitete të tjera)	52,0	48,0	52,0	48,0	52,5	47,5
Komunikimi me mesazhe të shkruara (Skype, Messenger apo WhatsApp)	51,3	48,7	51,6	48,4	51,1	48,9
Leximi i lajmeve në gazeta / revista në internet	53,1	46,9	53,8	46,2	53	47

Shikimi i kanaleve televizive ose videove të transmetuara në internet	54,2	45,8	..	..	53,8	46,2
Luajtja ose shkarkimi i lojërave	57,5	42,5	..	..	57,1	42,9
Dëgjimi i muzikës (radio në internet, transmetim i muzikës)	52,1	47,9	..	..	52	48
Blerje online e librave/ revistave/ gazetave	19,1	80,9	22,2	77,8	41,6	58,4

Burimi: Anketa e përdorimit të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK) në Familje dhe nga Individët

Përdorimi i internetit për blerjen e mallrave dhe shërbimeve kulturore

Një mjet alternativ për të analizuar pjesëmarrjen kulturore përmes anketës së përdorimit të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit është studimi i përqindjes së njerëzve që përdorin internetin në tre muajt e fundit, për të blerë mallra dhe shërbime kulturore.

24,6% e individëve 16-74 vjeç e kanë përdorur internetin për blerje online 'Bileta për evente kulturore dhe sportive', 18,4% kanë kryer blerje online për 'Libra, gazeta dhe revista' dhe 5,6% për 'Filma dhe muzikë'.

Në përgjithësi, janë femrat ato që e përdorin më shumë internetin për blerje online, model që vihet re dhe te shërbimet kulturore lidhur me kategoritë 'Libra, gazeta dhe revista' dhe 'Filma dhe muzikë'. Ndërkohë, te kategoria 'Bileta për evente kulturore dhe sportive' dominojnë dukshëm meshkujt.

Të rinjtë e grup-moshës 16-24 vjeç e kanë përdorur më shumë internetin për blerje online të 'Biletave për evente kulturore dhe sportive', ndërkohë grup-mosha 25-54 vjeç e ka përdorur më shumë internetin për blerje online të 'Librave, revistave, gazetave'.

Tab. 8 Përdorimi i internetit për blerje online, 2022

(% e individëve mes individëve që përdorin internetin në tre muajt e fundit)

2022		Bileta për evente (përfshirë evente sportive)	Libra, revista, gazeta	Filma, muzikë
	Gjithsej	24,6	18,4	5,6
Grup-mosha	16-24	27,6	16,2	7,0
	25-54	24,1	18,0	5,5
	55-74	17,1	33,2	--
Gjinia	Male	30,3	16,9	6,0
	Female	19,9	19,6	7,2

Burimi: Anketa e përdorimit të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK) në Familje dhe nga Individët

ARSIMI KULTUROR

Arsimi në kulturë pasqyron informacion të fokusuar në dy drejtime, të cilat lidhin arsimin me kulturën. Pjesa e parë mbulon statistika të regjistrimeve të studentëve në arsimin e lartë, në fusha të lidhura me kulturën. Ndërkohë, pjesa e dytë fokusohet në shkëmbimin kulturor, përkatësisht të studentëve të huaj të cilët studiojnë në Universitetet Shqiptare. Të dhënat janë administrative dhe janë siguruar nga Ministria e Arsimit, Rinisë dhe Sportit. Bazuar në klasifikimin e fushave të studimit (ISCED-F 2013), fushat që konsiderohen të lidhura me kulturën janë “Arte”, “Shkenca Humane dhe Gjuhët”, “Gazetari dhe Informim”, dhe “Arkitekturë dhe Ndërtim”.

Në vitin akademik 2022-23, në fushat e studimit të lidhura me kulturën janë regjistruar 14.530 studentë, të cilët përbëjnë 12,0% të totalit të regjistrimeve për këtë vit akademik. Në totalin e studentëve të regjistruar në fushat e lidhura me kulturën, “Arkitekturë dhe Ndërtim” dhe “Gjuhët” janë fushat e studimit më të preferuara nga studentët, përkatësisht me 40,3% dhe 30,0%.


Tab. 9 Studentë të regjistruar në arsimin e lartë në fushat e studimit të lidhura me kulturën

FUSHA	2021-2022	2022-2023
Arte	1.997	2.098
Shkenca Humane	1.738	1.473
Gjuhët	5.801	4.355
Gazetari dhe informim	961	747
Arkitekturë dhe ndërtim	5.649	5.857
Gjithsej	16.146	14.530

Burimi: Ministria e Arsimit, Rinisë dhe Sportit, INSTAT


Për tre vitet e fundit akademik, vihet re se çdo fushë arsimore e lidhur me kulturën është më e preferuar nga femrat. Në vitin akademik 2022-23, përkatësisht 14,5% e femrave janë regjistruar në këto fusha, krahasuar me 11,0% meshkuj, ndaj totalit të regjistrimeve për secilën gjini.

Fig. 4 Përqindja e studentëve të regjistruar në fushat e kulturës ndaj totalit të regjistrimeve sipas gjinisë



Në fushat e studimit të lidhura me kulturën, femrat përbëjnë shumicën e studentëve me 65,4%. Përqindja e femrave është më e lartë në fushat “Gjuhë” (83,6%), “Gazetari dhe informim” (77,6%) dhe “Shkenca humane” (75,1%) dhe më e ulët në fushën “Arkitekturë dhe ndërtim”, ku femrat përbëjnë 51,3% të studentëve në këtë fushë.

Fig. 5 Përqindja e studentëve të regjistruar në fushat e kulturës sipas gjinisë, 2022-23



Lëvizshmëria e të nxënësve në arsimin e lartë

Lëvizshmëria e të nxënësve në arsimin e lartë është përcaktuar si kalimi fizik i kufijve kombëtar ndërmjet vendit të origjinës dhe vendit të destinacionit dhe më pas pjesëmarrje në aktivitetet që lidhen me arsimin e lartë (në vendin e destinacionit). Ky seksion përfshin vetëm student të huaj të cilët janë regjistruar për studime të arsimit të lartë në Shqipëri.

Studimi jashtë vendit të origjinës u ofron studentëve mundësinë të përjetojnë sistemin tonë arsimor dhe të njohin dhe zbulojnë kulturën e vendit tonë, si vend pritës.


Në vitin akademik 2022-23, nga totali i studentëve të regjistruar në arsimin e lartë, 1,7% ishin të huaj. Për të tre vitet e fundit akademik, studentët e huaj meshkuj dominojnë krahasuar me studentet e huaja femra. Shumica e studentëve vijnë nga Italia (51,5%) dhe nga Kosova (18,8%).

Tab.10 Studentë të huaj të regjistruar në arsimin e lartë

Viti	Femra	Meshkuj	Total
2020-21	1,4%	2,2%	1,7%
2021-22	1,4%	1,7%	1,5%
2022-23	1,5%	1,9%	1,7%

Burimi: Ministria e Arsimit, Rinisë dhe Sportit, INSTAT


Fig. 6 Përqindja e studentëve të huaj të regjistruar në arsimin e lartë, sipas vendit të origjinës, 2022-23



Burimi: Ministria e Arsimit, Rinisë dhe Sportit, INSTAT

Shumica e studentëve të huaj janë regjistruar për studime Master dhe Bachelor. Në Programet 2 vjeçare dhe Bachelor ka më shumë student meshkuj të huaj, ndërkohë në programet Master ka më shumë studente femra të regjistruara. Në Doktoraturë janë regjistruar vetëm studentë të huaj meshkuj.

Fig. 7 Përqindja e studentëve të huaj të regjistruar në nivelet e arsimit të lartë sipas gjinisë, 2022-23



Burimi: Ministria e Arsimit, Rinisë dhe Sportit, INSTAT

Tab.11 Studentë të huaj të regjistruar në arsimin e lartë sipas nivele arsimore

Viti	2020-21	2021-22	2022-23
Programe 2 vjeçare	0,7%	0,6%	0,9%
Bachelor	25,2%	25,4%	30,6%
Master	63,5%	69,8%	68,0%
Doktoraturë	10,6%	4,2%	0,4%
Gjithsej	2.088	1.872	2.012

Burimi: Ministria e Arsimit, Rinisë dhe Sportit, INSTAT

PUNËSIMI NË KULTURË

Informacioni mbi punësimin në kulturë është siguruar nga Anketa e Forcave të Punës dhe përfaqëson punësimin e individëve në moshën 15 vjeç e lart sipas aktiviteteve ekonomike ose sipas profesioneve të cilat lidhen me fushën e kulturës.

Në vitin 2022, janë të punësuar në një aktivitet kulturor ose në një profesion kulturor 24.132 individë, që përbëjnë 1,9% të punësimit gjithsej. Krahatur me vitin e kaluar, punësimi në kulturë pësoi një rritje me 0,2 pikë përqindje. Shumica e të punësuarve në kulturë janë meshkuj, respektivisht 58,9% në vitin 2022. Kjo përqindje është rritur me 0,6 pikë përqindje krahasuar me vitin e kaluar.






Fig. 8 Punësimi në kulturë sipas gjinisë, (në %)



Burimi: Anketa e Forcave të Punës

Përqindja që zënë femrat në punësimin në kulturë ka një vlerë më të ulët krahasimisht me përqindjen që ato zënë në punësimin e gjithë ekonomisë (46,0%).

Ndërkohë që të rinjtë në moshën 15-29 vjeç përbëjnë vetëm 20,9% të punësimit gjithsej në vend, pjesëmarrja e tyre në punësimin në kulturë është më e lartë, 30,0% në vitin 2022. Krahimisht me vitin e kaluar ka pësuar rënie me 0,2 pikë përqindje.

30,0 %

Fig. 9 Përqindja e të rinjve 15-29 vjeç në punësimin në kulturë dhe në punësimin gjithsej

Burimi: Anketa e Forcave të Punës

● 2022 ● 2021

% e të rinjve 15-29 vjeç në punësimin në kulturë

20,9 %

% e të rinjve 15-29 vjeç në punësimin gjithsej

30,2 %


% e të rinjve 15-29 vjeç në punësimin në kulturë

% e të rinjve 15-29 vjeç në punësimin gjithsej

21,4 %

Të punësuarit me arsim të lartë përbëjnë pjesën më të madhe të të punësuarve në punësimin në kulturë, 66,5% në vitin 2022. E kundërta ndodh me shpërndarjen e punësimit gjithsej sipas nivelit arsimor, ku të punësuarit me arsim të lartë përbëjnë vetëm 23,7% të të punësuarve gjithsej.

Fig. 10 Shpërndarja e punësimit gjithsej dhe punësimit në kulturë sipas nivelit arsimor, (në %)



Burimi: Anketa e Forcave të Punës

INDEKSI I HARMONIZUAR I ÇMIMEVE TË KONSUMIT NË SHËRBIME DHE MALLRA KULTURORE

Niveli dhe struktura e çmimeve të mallrave dhe shërbimeve janë një nga përcaktuesit kryesorë të shpenzimeve familjare. Kështu, informacioni mbi indeksin e harmonizuar të çmimeve të konsumit plotëson të dhënat për shpenzimet private për mallrat dhe shërbimet kulturore. Indeksi ofron informacion mujor për ndryshimet e çmimeve në shërbime dhe mallra kulturore, duke lehtësuar kështu monitorimin e rregullt të çmimeve.

Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit (IHÇK) mat ndryshimin e nivelit të çmimeve me pakicë të mallrave dhe shërbimeve, të cilët konsiderohen kulturor nga pikëpamja e strukturës së shpenzimeve, të cilat konsumatori (vendas dhe i huaj) synon për konsumin final në territorin e Shqipërisë. Në vitin 2022, rritja më e lartë e çmimeve për mallrat dhe shërbimet kulturore është shënuar në kategorinë “Instrumenta muzikore” me 5,1%, pasuar nga “Shërbimet kulturore” me 2,4%.


Tab. 13 Indeksi i harmonizuar i çmimeve të konsumit për disa mallra dhe shërbime kulturore

Viti bazë: Dhjetor 2015 = 100

Shërbime/Mallra Kulturore	Year 2021	Year 2022
Pajisje audio-vizuale, fotografike dhe riparimi i tyre	96,3	96,4
Instrumenta muzikore	127,4	133,9
Shërbime kulturore	104,3	106,8
Libra	115,3	116,1
Gazeta dhe periodikë të tjerë	100,9	101,1

Burimi: Anketa e Çmimeve të Konsumit

Fig. 11 Ndryshimi vjetor në përqindje i indeksit të harmonizuar të çmimeve të konsumit për disa mallra dhe shërbime kulturore, 2022




Burimi: Anketa e Çmimeve të Konsumit

SHPENZIMET PUBLIKE PËR ARGËTIM, KULTURË DHE ÇËSHTJE FETARE

Ky seksion paraqet të dhëna në lidhje me shpenzimet publike për fushën Argëtim, Kulturë dhe Çështje Fetare. Këto shpenzime, ndër të tjera përbëjnë rëndësi për konsolidimin dhe promovimin e vlerave artistike, artit dhe aktiviteteve kulturore në arenën kombëtare dhe ndërkombëtare.

Në 2022, shpenzimet publike për Argëtim, Kulturë dhe Çështje Fetare përbëjnë 1,64 % të shpenzimeve publike gjithsej dhe zënë një peshë prej 0,50 % në PBB-në gjithsej. Krahësuar me vitin 2021, shpenzimet publike për Argëtim, Kulturë dhe Çështje Fetare shprehur si përqindje ndaj PBB-së janë rritur me 0,09 pikë përqindje, ndërsa në përqindje ndaj totalit të shpenzimeve publike janë rritur me 0,37 pikë përqindje.

Fig. 12 Shpenzimet publike për argëtim, kulturë dhe çështje fetare, (në %)



Burimi: INSTAT, Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

* Të dhënat janë gjysëm-finale

** Të dhënat janë bazuar në vlerësimet tremujore

SHËNIME METODOLOGJIKE



Pjesëmarrja kulturore

Përfshin të dhëna bazuar në anketën e të Ardhurave dhe Nivelit të Jetesës që INSTAT zhvillon dhe në të dhënat administrative, të siguruar nga Ministria e Kulturës lidhur me numrin e aktiviteteve kulturore dhe numrin e pjesëmarrësve në aktivitetet kulturore.

Anketa e të Ardhurave dhe Nivelit të Jetesës mbledh të dhëna për pjesëmarrjen në aktivitete kulturore me pagesë të individëve mbi 16 vjeç, sipas gjinisë. Aktivitetet kulturore përfshijnë vizitat në teatër, kinema, koncerte, aktivitete sportive etj.

Në institucionet qendrore të artit e të kulturës përfshihen: Teatri Kombëtar, Teatri Kombëtar i Operas, Baletit dhe Ansamblit Popullor, Teatri Kombëtar Eksperimental "Kujtim Spahivogli", Qendra Kombëtare Kulturore për Fëmijë dhe Cirk Kombëtar.



Trashëgimia kulturore

Të dhënat mbi trashëgiminë kulturore i referohen muzeve, kalave dhe parqeve arkeologjike, të cilat janë në varësi të Ministrisë së Kulturës. Institucionet e trashëgimisë kulturore përfshijnë institucionet:

Muze	Kala e monumente të tjerë	Park arkeologjik
Muzeu Historik Kombëtar, Tiranë	Kalaja Berat	Parku Kombëtar, Butrint
Muzeu Arkeologjik, Durrës	Kalaja Gjirokastrë	Parku Arkeologjik, Apolloni
Muzeu i Pavarësisë, Vlorë	Kalaja e Portopalmos	Parku Arkeologjik, Bylis
Muzeu Gjergj Kastrioti, Krujë	Kalaja e Kaninës	Parku Arkeologjik, Shkodër
Muzeu Etnografik, Krujë	Kalaja e Himarës	Parku Arkeologjik, Lezhë
Muzeu Etnografik, Berat	Amfiteatri	Parku Arkeologjik, Amantia
Muzeu Ikonografik Onufri, Berat	Manastiri i 40 Shenjtorëve	Parku Arkeologjik, Orikum
Muzeu i Artit Mesjetar, Korçë		Parku Arkeologjik, Finiq
Muzeu Arkeologjik, Korçë		Parku Arkeologjik, Antigone
Muzeu i Arsimit, Korçë		
Muzeu Kombëtar i Fotografisë Marubi		
Muzeu Kombëtar i përgjimeve "Shtëpia me Gjethe"		

Arsimi kulturor



Të dhënat mbi regjistrimet e studentëve në arsimin e lartë në fusha studimi të lidhura me kulturën janë siguruar nga Ministria e Arsimit dhe Sportit. Arsimi kulturor pasqyron gjithashtu të dhëna për shkëmbimin kulturor, duke u fokusuar te studentët e huaj që studiojnë në Universitetet Shqiptare. Bazuar në klasifikimin e fushave të studimit (ISCED-F 2013), fushat që konsiderohen të lidhura me kulturën janë:

Fushat në kulturë

021 Arte

022 Shkenca humane

023 Gjuhët

032 Gazetari dhe informim

073 Arkitekturë dhe ndërtim

Punësimi në kulturë



Të dhënat mbi punësimin në kulturë bazohen në Anketën e Forcave të Punës së Shqipërisë, të dhëna vjetore dhe mbulojnë popullsinë 15 vjeç e lart. Punësimi kulturor përfshin të gjithë personat që punojnë në aktivitete ekonomike që konsiderohen të jenë kulturore, pavarësisht nëse personi është i punësuar në një profesion kulturor. Ai gjithashtu mbulon personat me një profesion kulturor, pavarësisht nëse ata janë të punësuar në një aktivitet ekonomik jo-kulturor. Përkufizimi i punësimit kulturor përcaktohet në terma të Klasifikimit Statistikor të Aktiviteteve Ekonomike në Komunitetin Evropian (NACE Rev. 2) dhe Klasifikimit Standard Ndërkombëtar të Profesioneve (ISCO-08). Një listë e plotë e aktiviteteve ekonomike dhe profesioneve që janë përdorur për të përcaktuar punësimin kulturor është dhënë më poshtë:

Sektorët Kulturorë (aktivitetet ekonomike) — NACE Rev. 2

18 Shtypja dhe riprodhimi i mediave të regjistruara

32.2 Prodhimi i instrumenteve muzikore

58.1 Botimi i librave, revistave periodike dhe veprimtari të tjera botuese

59 Aktivitete të prodhimit të programeve filmike, video dhe televizive, regjistrim të zërit dhe muzikës

60 Aktivitete programuese dhe transmetuese

74.1 Aktivitete të specializuara të dizajnit

74.2 Aktivitete fotografike

74.3 Aktivitetet e përkthimit dhe interpretimit

90 Aktivitete krijuese, artistike dhe argëtuese

91 Biblioteka, arkiva, muze dhe veprimtari të tjera kulturore

Profesionet kulturore — ISCO-08

216 Arkitektë, planifikues, topografë dhe dizajnerë
2353 Mësues të tjerë të gjuhës
2354 Mësues të tjerë të muzikës
2355 Mësues të tjerë të arteve
262 Bibliotekarë, arkivistë dhe kuratorë
264 Autorë, gazetarë dhe gjuhëtarë
265 Artistë krijues dhe interpretues
3431 Fotografi
3432 Dizenjues dhe dekorues të brendshëm
3433 Teknikë të galerisë, muzeut dhe bibliotekës
3435 Profesionistë të tjerë të asociuar artistikë dhe kulturorë
3521 Teknikë transmetimi dhe audio-vizualë
4411 Nëpunës të bibliotekës
7312 Prodhues dhe akordues të instrumenteve muzikore
7313 Punëtorë të stolive dhe metaleve të çmuar
7314 Poçarë dhe punëtorë të ngjashëm
7315 Prodhues të qelqit, prerës, bluarës dhe ilustrues
7316 Shkrimtarë shenjash, piktorë dekorativë, gdhendës dhe të tjerë
7317 Punëtorë artizanalë në dru, shporta dhe materiale të ngjashme
7318 Punëtorë artizanalë në tekstil, lëkurë dhe materiale të ngjashme
7319 Punëtorë artizanalë të pa klasifikuar diku tjetër



Përkufizimi i fushës/shtrirjes së punësimit kulturor – shembuj

Punësimi		Aktivitetet ekonomike (NACE Rev.2)	
Profesionet (ISCO-08)		Kulturore	Jo-Kulturore
	Kulturore	Kërcimtar në një kompani baleti	Dizenjator në një industri automobilash
	Jo-Kulturore	Financier në një shtëpi botuese	



Përdorimi i internetit për qëllime kulturore

Të dhënat mbi përdorimin e rregullt të internetit (3 muajt e fundit) nga individët 16-74 vjeç janë siguruar nga anketa e përdorimit të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK) në Familje dhe nga Individët, që INSTAT zhvillon me periodicitet vjetor.

Aktivitet online kulturore përfshijnë pjesëmarrjen në rrjete sociale, leximi i gazetave, revistave në internet, komunikimi me mesazhe të shkurtra dhe blerjet online të librave, revistave, gazetave.

Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit



Të dhënat mbi indeksin e harmonizuar të çmimeve të konsumit lidhur me mallrat dhe shërbimet kulturore janë siguruar nëpërmjet anketës të Çmimeve të Konsumit, që INSTAT zhvillon me periodicitet mujor. Ky tregues bazohet në Klasifikimin Europian të Shpenzimeve Individuale sipas Qëllimit (ECOICOP) me 12 ndarje kryesore.

ECOICOP –qëllime kulturore

CP091 Pajisje audio-vizuale, fotografike dhe riparimi i tyre

CP09221 Instrumenta muzikore

CP0942 Shërbime kulturore

CP0951 Libra

CP0952 Gazeta dhe mjete shkollore

Shpenzimet Publike për Argëtim, Kulturë dhe Çështje Fetare



Të dhënat mbi shpenzimet publike për fushën e kulturës janë siguruar nga INSTAT dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë.



Përkufizime

Trashëgimia kulturore është tërësia e pasurive kulturore, materiale dhe jomateriale, të një individi, grupi ose shoqërie të trashëguara nga e kaluara që ruhen në të tashmen, për t'ua përçuar brezave në të ardhmen, si pjesë e pasurisë kombëtare të një vendi, të cilat shprehin vlerat, identitetin, njohuritë, traditat, besimet si dhe pasuritë kulturore.

Muze është institucioni i ruajtjes së kujtesës, në shërbim të shoqërisë dhe zhvillimit të saj, i hapur për publikun, që konservon, studion, komunikon dhe prezanton trashëgiminë e luajtshme e të paluajtshme të njerëzimit dhe mjedisit rrethues të tij, me qëllim edukimin, studimin, promovimin dhe argëtimin.

Monument kulture është objekti ose ndërtimi me vlera historiko-kulturore, që mbrohet nga shteti.

Park arkeologjik është territori i përcaktuar me kufij të qartë, që përfshin dëshmi të rëndësishme arkeologjike të mbitokës, nëntokës e nënujit dhe bashkëprani të pasurive historike, peizazhit kulturor, i organizuar me elemente të një muzeu në natyrë.

Blerjet "online" i referohen porosive të mallrave ose shërbimeve nëpërmjet internetit, blerjeve të tyre nëpërmjet internetit (e-blerje) për qëllime personale nëpërmjet çdo lloji pajisjeje (desktop, i lëvizshëm ose i dorës, përfshirë telefonin celular ose telefon smart).

STATISTIKA TË KULTURËS

2022